

VENDIM
Nr. 160, datë 30.12.2020

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME MALËSI E MADHE
SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.12.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe (UK Malësi e Madhe), me shkresën nr. 1037 prot., datë 1.12.2020, si dhe plotësimet me shkresë përcjellëse nr. 1300 prot., datë 14.12.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, të UK Malësi e Madhe, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Malësi e Madhe ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 31 071 banorë të Bashkisë Malësi e Madhe;

b) Drejtues teknik i shoqërisë, z. Adi Hasanaj, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega “Hidroteknikë” dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Malësi e Madhe, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Malësi e Madhe është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. me (NUIS: K48420718C), në kategoritë:

- a) kategoria A - për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) kategoria C - për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) drejtues ligjor – Ndoc Prela;
- b) drejtues teknik – Adi Hasanaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. është Bashkia Malësi e Madhe.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani